

# VAKSINIME PËR TË GJITHË

## Vaksinat përforcuese kundër COVID-19 Pyetje të shpeshta

Injeksionet përforcuese kundër COVID-19 rekomandohen për këdo nga moshë 5 vjeç e lart që ka kryer serinë e vaksinave primare kundër COVID-19 (personat e moshës 5-11 vjeç që kanë kryer vaksinën e Moderna si seri primare nuk kualifikohen ende për injeksionet përforcuese). Personat e moshës 5-11 vjeç duhet të kryejnë injeksionin përforcues origjinal monovalent të Pfizer. Personat e moshës 12 vjeç e lart duhet të kryejnë injeksionin përforcues të përditësuar bivalent.

### Çfarë është injeksioni përforcues?

Injeksioni përforcues është një dozë shtesë e një vaccine pas kryerjes së një serie vaksinash primare dhe përdoret për të përforcuar imunitetin kundër virusit pasi mbrojtja mund të ketë rënë me kalimin e kohës (ky quhet imunitet në rënie).

### Kush mund ta bëjë injeksionin përforcues?

Gjithkush i moshës 5-11 vjeç duhet të bëjë një dozë të injeksionit përforcues monovalent origjinal të paktën pesë muaj pas bërjes së dozës së dytë të serisë primare të vaksinimit të Pfizer. Për momentin ata që kanë kryer vaksinën e Moderna si serinë e tyre primare nuk kualifikohen ende për injeksionet përforcuese.

Për personat e moshës 12 vjeç e lart, injeksioni i vetëm përforcues i autorizuar është ai i përditësuar bivalent. Personat e moshës 12 vjeç e lart nuk mund ta kryejnë më injeksionin përforcues origjinal monovalent.

Personat e moshës 12 vjeç e lart duhet të marrin një dozë të injeksionit përforcues të përditësuar bivalent të paktën dy muaj pas serisë së tyre primare të vaksinave kundër COVID-19 ose injeksionit të fundit përforcues.

Injeksioni përforcues i përditësuar bivalent i Pfizer-BioNTech është i autorizuar për personat e moshës 12 vjeç e lart; dhe injeksioni përforcues bivalent i përditësuar i Moderna është i autorizuar për ata të moshës 18 vjeç e lart.

### Si ndryshon injeksioni i përditësuar përforcues bivalent nga injeksioni përforcues origjinal monovalent.

Injeksioni i ri përforcues është vaksinë "bivalente", që do të thotë se është një formulë e re që përmban një kombinim të vaksinës origjinale si dhe një vaksinë të re që shënjestron Omikronin dhe nënvariantt e tij, BA.4 dhe BA.5. Ndaj dhe konsiderohet "i përditësuar".

### Përse rekomandohet injeksioni përforcues?

Vaksinat kundër COVID-19 janë ende efikase në parandalimin e sëmundjeve të rënda, shtrimit në spital dhe vdekjes për shkak të COVID-19. Sidoqoftë studimet tregojnë se mbrojtja ndaj infeksionit e vaksinave kundër COVID-19 fillon të bjerë me kalimin e kohës. Vakcina përforcuese mund të ofrojë mbrojtje të mëtejshme për njerëzit duke u "përforcuar" sistemin imunitar, sidomos tak ata që janë në rrezik të shtuar sëmundjes së rëndë të COVID-19.

## **Çfarë problemesh mjekësore e rrisin rrezikun për sëmundje të rënduar të COVID-19?**

Problemet mjekësore që rrisin rrezikun e COVID-19 të rënduar përfshijnë diabetin, problemet e zemrës (duke përfshirë tensionin e lartë), sëmundjen kronike të veshkave, sëmundjen kronike të mushkërive, sëmundjen e mëlçisë, kancerin, demencën, HIV dhe shtatzëninë. Për një listë të plotë, shikoni: [cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/needextraprecautions/people-with-medical-conditions.html](https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/needextraprecautions/people-with-medical-conditions.html)

## **Kush është në rrezik të shtuar ekspozimi ndaj COVID-19 në ambientin e punës apo ambiente të tjera?**

Punët që mund të shtojnë rrezikun e ekspozimit ndaj COVID-19 përfshijnë punonjësit shëndetësorë, mësuesit, personelin e kujdesit ditor dhe punonjësit e restoranteve dhe të ushqimoreve. Ambiente të tjera ku mund të ketë rrezik të shtuar ekspozimi përfshijnë qendrat për të pastrehët dhe burgjet.

## **Si ta kuptoj nëse kam nevojë për injeksion përforcues?**

Flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor nëse keni pyetje për bërjen e injeksionit përforcues. Nëse keni nevojë për ndihmë për të gjetur një ofrues, telefononi në nr. 311 ose në nr. 212-COVID-19 (212-268-4319) dhe flisni me një infermier për të mësuar nëse kualifikoheni.

## **A mund ta bëjnë përforcuesen personat shtatzëna, që ushqejnë me gjë ose që planifikojnë të mbeten shtatzëna?**

Personat që janë aktualisht apo kanë qenë së fundi shtatzëna kanë rrezik të shtuar që të pësojnë sëmundje të rënda nga COVID-19 në krahasim me joshtatzënat. Shtatzënat duhet të vaksinohen kundër COVID-19. Nëse shtatzënat i plotësojnë kriteret kualifikuese, duhet të bëjnë injeksion përforcues.

## **Cilat janë rreziqet që vijnë nga bërja e injeksionit përforcues?**

Përfitimet e kryerjes së injeksionit përforcues janë më të mëdha se rreziqet. Deri më tani reaksionet e raportuara pas bërjes së injeksionit përforcues kanë qenë të njëjta me ato pas dozave fillestare të vaksinës. Lodhja dhe dhimbja në krah kanë qenë efektet më të raportuara anësore. Shumica e efekteve anësore kanë qenë të lehta deri në mesatare dhe janë larguar vetë.

## **A është e nevojshme që marka e injeksionit tim përforcues të jetë e njëjtë me të vaksinës së parë që bëj?**

Të vaksinuarit mund të kryejnë të njëjtën vaksinë që kanë bërë fillimisht si serinë e tyre primare të vaksinës ose si injeksionin përforcues të mëparshëm, ose mund të kalojnë te cilido dy llojet e tjera të vaksinave.

## **Nëse na duhet një injeksion përforcues, a do të thotë kjo që vaksinat nuk po bëjnë punë?**

Jo. Vaksinat kundër COVID-19 po funksionojnë mirë për të parandaluar sëmundjen e rëndë, shtrimin në spital dhe vdekjen. Por ekspertët e shëndetit publik kanë filluar të shohin rënie të lehta në mbrojtje me kalimin e kohës, sidomos mes popullatash të caktuara të rrezikut të lartë.

## **Ku mund ta bëj vaksinën përforcuese falas?**

Injeksionet përforcuese të përditësuara të Pfizer ofrohen në të 11 spitalet e sistemit të NYC Health + Hospitals. Injeksionet përforcuese të përditësuara të Moderna ofrohen në cilëndo qendër të NYC Health + Hospitals/ Gotham Health. Nuk ka nevojë të shkoni në të njëjtën qendër ku keni bërë serinë primare të vaksinave apo injeksionin përforcues të mëparshëm. Takimet e çastit ofrohen në qendra të caktuara. Telefononi në nr. 1-877-829-4692 për ndihmë në gjuhë të ndryshme.

## **A mund ta bëj injeksionin përforcues njëherësh me vaksina të tjera (si p.sh. vaksinën kundër gripit)?**

Po. Bërja e injeksionit përforcues njëherësh apo në çfarëdo kohe para apo pas vaksinave të tjera është e sigurt. Nëse nuk e keni bërë ende vaksinën kundër gripit, të dyja do të ofrohen në qendrat spitalore të kujdesit të shpejtë të NYC Health + Hospitals.

## **A më duhet injeksioni përforcues për t'u vaksinuar plotësisht?**

Jo. Njerëzit konsiderohen plotësisht të vaksinuar dy javë pas dozës së dytë të një vaksine dydozëshe (si p.sh. Pfizer ose Moderna) ose dy javë pas vaksinës njëdozëshe të J&J.

## **A do të bëhen me detyrim ligjor injeksionet përforcuese?**

Detyrimi ligjor për vaksinim i shtetit të Nju-Jorkut për punonjësit e kujdesit shëndetësor vlen vetëm për dozat e para dhe të dyta. Detyrimi ligjor nuk përfshin injeksionet përforcuese.

## **A rekomandohen injeksionet përforcuese për fëmijët?**

Për momentin të gjithë personat 5 vjeç e lart inkurajohen të bëjnë një injeksion përforcues (ata 5-11 vjeç që bëjnë Moderna si serinë e tyre primare nuk kualifikohen ende për injeksionet përforcuese). Personat 5-11 vjeç që kanë bërë më parë serinë primare të Pfizer mbi 5 muaj më parë përfitojnë vetëm injeksionin përforcues monovalent të Pfizer. Personat e moshës 12 vjeç e lart kualifikohen për injeksionet përforcuese të përditësuara bivalente të Pfizer dhe ata 18 vjeç e lart kualifikohen për injeksionet përforcuese të përditësuara bivalente dy muaj pas vaksinës së tyre primare kundër COVID-19 ose injeksionit të fundit përforcues.